

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L

Për: **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	612-26-4495-2-1-1
------------------	-------------------

Titulli: **Rrënimi i objekteve pa leje ndërtimore dhe objekteve të tjera në Komunen e Fushë Kosovës**

OE Company Murseli Shpk

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Doganaj
(Adresa)

Kacanik
(Vendi)

70520
(Kodi postar)

049 434 666
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Rexhep Murseli
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Company Murseli SH.P.K

info@murselicompany.com
(Adresa elektronike)


Rexhep Murseli – Drejtor

31.08.2026

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për kontratë: 09.06.2026
Data e procesverbalit të hapjes: 21.07.2026
Njoftimi mbi vendimin e AK: 12.08.2026
Kërkesa për rishqyrtim: 17.08.2026
Njoftimi mbi vendimin e AK: 19.08.2026
Ankese në OSHP: 31.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Data e procesverbalit të hapjes: 21.07.2026

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji për Prokurim Publik i konsoliduar

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit;
Neni 25.8 Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit
Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës ;
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;
Neni 69 Kapaciteti teknik dhe profesional;
Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.
Neni 131 Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues.

Rregullorja nr. 001/2022, per Prokurim Publik

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;
Neni 97 Shkeljet e Renda

Udhëzuesi për Prokurim publik 001/2023.

Neni 10 - Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Te nderuar,

Më datë 12.08.2026, Autoriteti Kontraktues, ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e AK-se apo formulari B58, me të cilin kane rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin "Ermal Sylaj B.I.", kunderligjeshëm dhe përmes të njëjtit njoftim, kane nxjerrur vendimin si OE te pasuksesshëm nga qe tenderi juaj nuk qe me i lirë.

Me te marre vendimin kemi kerkuar qasje, tek OE i rekomanduar qasja na eshte lejuar dhe ne vazhdim ju bashkangjesim pretendimet ankimore te cilat eshte dashur qe ta eliminoj OE te rekomanduar me patjeter dhe ne asnje menyre te rekomandohet per kontrate.

Pretendimi ankimore 1.

Në FDT, pikat 9.1 & 9.2, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar: “**Kërkesa numër 1. Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë prej min. 375,000.00 euro. Në rast të grupit lideri duhet të ketë së paku 60 % të shumës së kërkuar të kontratave të natyrës së ngjajshme.**

Pra lënda e këtij aktiviteti të prokurimit, sipas specifikimeve teknike, përfshin ekskluzivisht Punë të demolimit, thyerjes së materialeve të forta beton, asfalt, punë me çekan e gërrshërë demolimi dhe transport të materialeve nga demolimi.

OE i rekomanduar "Ermal Sylaj B.I.", për të arritur dhe përmbushur vlerën e kërkuar, ka prezantuar kontratat, *"Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimit në Komunën e Suharekës"*, me vlerë 247,063.47 € dhe kontratën *"Ndërtimi i kanalizimit dhe kubëzimi në rrugën Brezne-Likeni në fshatin Brezne - Komuna Dragash"*, me vlerë 226,071.40 €.

Komisioni i Vlerësimit ka bërë shkelje të teresishme të nenit 59 të LPP-së, duke i konsideruar këto kontrata si të "natyrës së ngjashme" dhe se ndërtimi i rrjeteve të kanalizimit, instalimi i gypave dhe shtrimi i rrugëve me kubëza apo zhavorr, paraqesin punë të ndërtimit të infrastrukturës dhe nuk kanë asnjë ngjashmëri teknike dhe operationale apo strukturore me rrënimin e objekteve dhe demolimin e strukturave të betonit.

E vetmja kontratë që përmban elemente të demolimit në ofertën e këtij operatori është kontrata e *Parkut në Kalabri - Faza e I-rë Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave të betonit*, mirepo vlera e kësaj kontrate është vetëm 80,850.00 €, dhe një kontratë tjetër *Rrënimi i objekteve ndërtimore pa leje në Komunën e Fushe Kosovës* me vlerë prej 80,000.00€ si e tillë nuk e përmbushë pragun minimal kualifikues prej 375,000.00 € të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Supozojmë që këto dy kontrata janë të ngjajshme po që të dyjat arrijnë vlerën 160,850.00 €.

Dhe si i tillë AK do duhet ta eliminon nga gara pas rivlersimit.

Pretendendimi ankimore 2.

MOSPËRMBUSHJA E KËRKESËS PËR 60% NGA LIDERI I GRUPIT

Në kuadër të aktivitetit të prokurimit **"Rrënimi i objekteve pa leje ndërtimore dhe objekteve të tjera në Komunën e Fushë Kosovës"**, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të detyrueshme Kërkesën Nr. 1, sipas së cilës Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë përfundimin me sukses të kontratave të natyrës së ngjashme gjatë tri (3) viteve të fundit, në vlerë minimale prej **375,000.00 €**, ndërsa në rast të grupit të operatorëve ekonomikë, **lideri duhet t'i ketë së paku 60% të shumës së kërkuar të kontratave të natyrës së ngjashme.**

Ky formulim nuk lë hapësirë për interpretim se 60% duhet të plotësohet nga grupi në tërësi. Përkundrazi, kërkesa ia atribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe individuale këtë obligim **liderit të grupit.**

Në rastin konkret, lider i grupit të rekomanduar për kontratë është **Ermal Sylaj B.I.**, ndërsa partner është **AAB Construction SHPK.**

Rrjedhimisht, minimumi që duhet ta dëshmojë lideri Ermal Sylaj B.I. është:

$$375,000.00 \text{ €} \times 60\% = 225,000.00 \text{ €}$$

Pra, Ermal Sylaj B.I. duhet të dëshmojë në emër të vet dhe sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit së paku **225,000.00 € kontrata të përfunduara me sukses dhe të natyrës së ngjashme.**

Nga lista e kontratave të paraqitur nga vetë Ermal Sylja B.I. rezulton se kontrata që ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e këtij aktiviteti është:

“Rrëni i objekteve pa leje ndërtimore dhe objekteve të tjera në Komunën e Fushë Kosovës” – 80,000.00 €.

Kjo kontratë është veçanërisht domethënëse, sepse përkon drejtpërdrejt me natyrën dhe objektin e aktivitetit aktual të prokurimit.

Ndërkohë, kontratat e tjera të paraqitura nga Ermal Sylja B.I. janë kryesisht kontrata për:

- shtrim zhavorri në rrugë;
- ndërtim dhe sanim të kanalizimeve;
- ndërtim të rrugëve;
- ndërtim të parqeve;
- trajtim të mbeturinave ndërtimore dhe ilegale;
- kubëzim;
- ndërtim të rrugëve lokale.

Këtu qëndron thelbi i çështjes: **fakti që Ermal Sylja B.I. ka paraqitur një listë me vlerë totale 1,038,761.57 € nuk do të thotë automatikisht se ai e ka përmbushur kërkesën e Dosjes së Tenderit**, sepse kërkesa nuk është “kontrata çfarëdo në vlerë 375,000.00 €”, por është shprehimisht për **kontrata të natyrës së ngjashme** dhe, në rast grupi, lideri duhet të ketë së paku 60% të kësaj vlere.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues nuk mund të mjaftohet me mbledhjen aritmetike të të gjitha kontratave të paraqitura në listën e Ermal Sylja B.I., pa analizuar natyrën reale të secilës kontratë.

Edhe në interpretimin më të favorshëm për operatorin e rekomanduar, kushti nuk plotësohet

Edhe nëse, vetëm për hir të argumentit, do të pranohej se kontrata:

“Parku ne kalabri – Faza e I-re Mobilizimi dhe Demolimi I strukturave te betonit” ne vlere prej 80,850.00€ mund të konsiderohet kontratë e natyrës së ngjashme me aktivitetin e rrënimit të objekteve, atëherë shumta e liderit do të ishte:

$$80,000.00 \text{ €} + 80,850.00 \text{ €} = 160,850.00 \text{ €}$$

Ndërsa kërkesa minimale për liderin është: **225,000.00 €**

Pra, edhe në këtë interpretim maksimalisht favorizues për Ermal Sylja B.I., lideri përsëri mbetet nën pragun e detyrueshëm me:

$$225,000.00 \text{ €} - 160,000.00 \text{ €} = 64,150.00 \text{ €}.$$

Kjo është një mangësi objektive dhe matematikisht e verifikueshme.

Referencat e AAB Construction SHPK nuk mund ta korrigjojnë mungesën e liderit

Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se fakti që partneri **AAB Construction SHPK** ka paraqitur kontrata në vlerë mbi 4,000,000.00 € nuk mund të përdoret për ta kompensuar mungesën eventuale të liderit.

Nëse Autoriteti Kontraktues do t'i përdorte referencat e AAB Construction SHPK për ta plotësuar pragun prej 60% të liderit Ermal Syla B.I., atëherë do ta bënte praktikisht të pavlefshme vetë kërkesën e Dosjes së Tenderit që **“lideri duhet t'i ketë së paku 60%”**.

Një interpretim i tillë do ta shndërronte kërkesën në një kërkesë krejtësisht tjetër, përkatësisht që “grupi në tërësi duhet të ketë 60%”, gjë që **nuk është ajo që ka kërkuar Autoriteti Kontraktues**.

Prandaj, AAB Construction SHPK mund të dëshmojë kapacitetin e vet, por nuk mund të përdoret për të mbuluar një kriter që Dosja e Tenderit ia ka ngarkuar në mënyrë specifike liderit.

Kjo është në përputhje edhe me logjikën e interpretimit të KRPP-së për referencat në rastet e konsorciumeve, sipas së cilës referencat e një grupi lidhen me punët e kryera nga anëtari përkatës dhe nuk mund të trajtohen automatikisht si 100% të përvojës së secilit anëtar.

Shkelja nuk është formale, por materiale

Kjo nuk është një mangësi formale apo një çështje që mund të korrigjohet përmes sqarimit pas hapjes së ofertave.

Bëhet fjalë për një **kriter të përshtatshmërisë/kapacitetit profesional dhe teknik**, i cili është vendosur nga vetë Autoriteti Kontraktues si kusht për pjesëmarrje dhe vlerësim.

Nëse lideri nuk e dëshmon minimumin prej **225,000.00 €**, atëherë mungon një element thelbësor i përgjegjshmërisë së ofertës.

Pranimi i ofertës pavarësisht kësaj mangësie do të krijonte një situatë të papranueshme ku një operator ekonomik që nuk e ka plotësuar kriterin e përcaktuar në Dosjen e Tenderit do të trajtohej më favorizueshëm sesa operatorët ekonomikë që e kanë respektuar atë.

Kjo cenon edhe parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe zbatimin e njëjtë të kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Për të gjitha arsyet e lartcekura, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues dhe, në rast të rivlersimit, të analizojnë në mënyrë individuale secilën kontratë të paraqitur nga lideri **Ermal Syla B.I.**, duke vlerësuar jo vetëm vlerën financiare, por edhe:

1. natyrën e kontratës;
2. objektin konkret të kontratës;
3. datën e përfundimit;
4. nëse kontrata është e përfunduar me sukses;

5. nëse kontrata është e natyrës së ngjashme me objektin e këtij aktiviteti;
6. dhe nëse, pas kësaj analize, lideri arrin minimumin e detyrueshëm prej **225,000.00 €**.

Në veçanti, kërkojmë që të mos përdoren kontratat e partnerit **AAB Construction SHPK** për të mbuluar mungesën e liderit, pasi një veprim i tillë do të ishte në kundërshtim me formulimin e qartë të kriterit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Nëse, siç rezulton nga dokumentacioni i paraqitur, Ermal Sylja B.I. nuk dëshmon së paku **225,000.00 € kontrata të pranueshme të natyrës së ngjashme**, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë **Ermal Sylja B.I. & AAB Construction SHPK** nuk e ka përmbushur **Kërkesën Nr. 1 të Dosjes së Tenderit** dhe, për rrjedhojë, **nuk mund të konsiderohet ofertues i përgjegjshëm dhe duhet të eliminohet nga procedura e prokurimit.**

Në të kundërtën, lejimi i këtij operatori të vazhdojë në procedurë do të nënkuptonte pranimin e një oferte që nuk e përmbush një kriter të shprehur qartë në Dosjen e Tenderit, ndërsa do të krijonte një standard të ndryshëm dhe më favorizues për operatorin e rekomanduar për kontratë.

Shiko listen e projekteve:

Aneksi 6. LISTA E KONTRATAVE TË REALIZUARA

Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe të bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton performimin e tillë

Nr.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e përfundimit të kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	E-maili i Blerësit	Nurmi i telefonit të Blerësit
1	Shtirimi me zhavor i rrugëve Komunen e Prishtine	13.12.2022	01.06.2023	65,050.00	KK Prishtine	zprokurimit.prishtine@rks-gov.net	038-244-613
2	Nërtimi dhe sanimi i kanalizimeve në Komunë, Suharekë, Samadraxhë, Bllacë, Sllapuzhan, Peqan, Semetisht, Reshtan, Studençan, Kastërc etj. - punë shtesë	27.07.2023	29.06.2023	24,704.20	KK Suharekë	zprokurimit.suhareke@rks-gov.net	029-271-026
3	Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimit në Komunë (Suharekë dhe fshatra)	06.08.2022	29.06.2023	247,063.47	KK Suharekë	zprokurimit.suhareke@rks-gov.net	029-271-026
4	"Ndërtimi i kanalizimeve përgjatë rrugëve në Komunën e Mamushës"	25.10.2023	09.02.2024	91,648.55	K. Mamushe	levent.mazrek@rks-gov.net	045-209-200
5	Ndërtimi i rrugëve lokale Rruga tek varrezat-vazhdim etj në Sllapuzhan	22.05.2024	22.12.2024	23,981.55	KK Suharekë	zprokurimit.suhareke@rks-gov.net	029-271-026
6	Parku në Kalabri- Faza e I-rë Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave të betonit	13.05.2024	10.10.2024	80,850.00	KK Prishtine	zprokurimit.prishtine@rks-gov.net	038-244-613
7	Trajtimi i mbeturinave ndërtimore (Deponive ilegale) - Lot 1	29.08.2023	21.01.2025	140,000.00	KK Prishtine	zprokurimit.prishtine@rks-gov.net	038-244-613
8	•047•Ndërtimi i kanalizimit dhe kubëzimi në rrugën Brezne-Likeni në fshatin Brezne (projekt 2 vjeçar) - RITENDERIM	17.08.2023	23.12.2024	226,071.40	KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI	nuro.ismail@yahoo.com	038-200-45509
9	Ndërtimi i rrugëve lokale Vazhdim i rruges Seferi, Dy Martiret, Veterani, etj në Grejëqec	14.10.2024	29.04.2025	59,392.40	KK Suharekë	zprokurimit.suhareke@rks-gov.net	029-271-026

10	Ndërtimi i rrugëve lokale 4 Lot - Lot 1 Qadraq; Lot 2 - Sllapuzhan; Lot 3 - Peqan; Lot 4 - Budakovë	05.08.2025	19.09.2025	18,327.94	KK Suharekë	zprokurimit.suhareke@rks-gov.net	029-271-026
11	Rrërimi i objekteve pa leje ndërtimore dhe objekteve tjera në Komunën e Fushë Kosovës	02.05.2025	03.04.2026	80,000.00	KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË	bedri.obertinca@rks-gov.net	+383 20040511
Gjithsej vlera e referencave:				1,038,761.57			

Bashkëngjit: certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat për caktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; që kopjet e certifikatave përkatëse t'ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues;

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një ofertë e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë të Operatoreve Ekonomik.

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik

Ermal Sylaj B.I.
N.T.S.H.
"RIJSHI"

Pretendimi ankimore 3

Kërkesa nr. 2 – Mosplotësimi i numrit minimal të punëtorëve nga lideri i Grupit

Pretendimi ynë është se lideri i Grupit të Operatorëve Ekonomikë, “**Ermal Sylaj B.I.**”, nuk e përmbush kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit për posedimin e **minimum 4 punëtorëve**, si kusht i domosdoshëm për liderin e grupit.

Nga lista e personelit të dorëzuar nga lideri rezultojnë 7 persona. Mirëpo, dy inxhinierët e deklaruar në listë janë pjesë e **stafit profesional** dhe nuk mund të llogariten si punëtorë për përmbushjen e kërkesës minimale prej 4 punëtorësh. Ndërsa, **z. Ermal Sylaj dhe z. Shaip Sylaj**, sipas të dhënave të paraqitura dhe statusit të tyre, janë pronarë të biznesit dhe nuk janë dëshmuar si punëtorë të angazhuar në kuptimin e kërkesës konkrete të Dosjes së Tenderit.

Rrjedhimisht, nga lista mbesin vetëm **3 persona të cilët mund të konsiderohen punëtorë**, përkatësisht Dren Elshani, Endrit Maliqaj dhe Fadil Balaj. Pra, lideri i Grupit **nuk i posedon minimum 4 punëtorë të kërkuar**, por vetëm 3.

Për këtë arsye, nuk është e ligjshme që AK të plotësojë këtë mungesë duke i konsideruar pronarët ose stafin profesional si punëtorë, në kundërshtim me mënyrën se si është përcaktuar kërkesa në Dosjen e Tenderit. Kriteret minimale të përcaktuara në DT janë detyruese dhe duhet të përmbushen nga ofertuesi në mënyrën e kërkuar nga AK.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që këtë mospërmbushje ta konsiderojë si mungesë të një kriteri minimal të kapacitetit teknik/profesional dhe, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, ta shpallë ofertën e Grupit të OE-ve të udhëhequr nga “Ermal Sylja B.I.” si ofertë të papërgjegjshme dhe ta eliminojë atë nga procedura e prokurimit.

Çdo trajtim ndryshe do të nënkuptonte pranimin e një oferte e cila **nuk e përmbush një kusht të shprehur dhe të detyrueshëm të Dosjes së Tenderit**, duke cenuar parimet e trajtimit të barabartë dhe vlerësimit të ofertave sipas kërkesave të përcaktuara në DT.

Shiko Listen:

Autoriteti Kontraktues	KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË
Nr. i prokurimit	612-26-4495-2-1-1
Nr. i brendshëm	612 26 028 211
Titulli:	Rrënimi i objekteve pa leje ndërtimore dhe objekteve të tjera në Komunën e Fushë Kosovës

Lista e Personelit					
Nr.	Emri	Mbiemri	Profesioni	Ekspierenca	Pozicioni
1	Uzair	Kapllani	Inxhinier	28 vite	Ing. I Ndërtimtarisë
2	Musli	Shala	Inxhinier	17 vite	Ing. I Hidroteknikes
3	Ermal	Sylaj	Pronari	15 vite	Eskavatorist
4	Shaip	Sylaj	Shofer	20 vite	Shofer Kamion
5	Dren	Elshani	Makinist	2 vite	Eskavatorist
6	Endrit	Maliqaj	Makinist	11 vite	Makinist Skip
7	Fadil	Balaj	Shofer	8 vite	Shofer kamioni

Suharekë:

20.07.2026



Pretendimi ankimore 4

Mospërmbushja e kriterit për Inxhinier të Mjedisit

Gjatë analizimit të ofertës së "Ermal Sylja BI, kemi konstatuar se e njëjta kompani ne oferte ka dorezuar marveshje bashkpunimit të datës 17.07.2026 për personin Arlinda Cakaj e lidhur me kompanin AAB Construction Shpk në pozicionin e Inxhinierit të Mjedisit dhe nga shqyrtimi i diplomës, të bashkëngjitur për këtë person e datës 25.07.2018, regjistri Nr. 1832, vërtetohet se znj Arlinda Cakaj, ka mbaruar studimet Bachelor në "Programin Studimor: Inxhinieri e Ambientit" ", ku

ky fakt tregon se znj. Arlinda Cakaj është bachelor i ndertimtarisë - dhe nuk posedon asnjë kualifikim, diplomë apo licencë në drejtimin e Mjedisit, prandaj prezantimi i tij për të përmbushur kriteret profesionale të fushës së Mjedisit është në kundërshtim të plotë me kërkesat kumulative të FDT-së, duke e bërë ofertën e tyre të papërgjegjshme edhe në aspektin profesional të stafit.

OE i rekomanduar për kontratë **nuk e përmbush kriterin 2.1 të DT-së**, i cili kërkon qartë dhe pa ekuivok **Inxhinier të Mjedisit, Bachelor ose Master, të certifikuar/licencuar nga OIK.**

Dokumentet e dorëzuara nga OE-ja e rekomanduar e dëshmojnë të kundërtën: **diploma e personit të propozuar është “Bachelor i Ndërtimtarisë” dhe jo “Bachelor/Master në Inxhinieri të Mjedisit”,** ndërsa edhe **licenca e paraqitur nuk është në drejtimin e Inxhinierisë së Mjedisit të kërkuar nga AK.**

Pra, kemi një mospërputhje të drejtpërdrejtë ndërmjet **asaj që ka kërkuar AK dhe asaj që OE ka ofruar dhe është rekomanduar për kontratë.** Kjo nuk është mangësi formale, por **mosplotësim i një kriteri të qartë dhe specifik të DT-së.**

Më shqetësuese është se OE-ja ka paraqitur dokumente që i përkasin **një profili tjetër profesional,** ndërsa personi është propozuar si përmbushës i kriterit për Inxhinier të Mjedisit. Një veprim i tillë ngre **dyshim serioz për paraqitje të informacionit materialisht të pasaktë/mashtrues,** i cili duhet të verifikohet nga AK para çdo vendimi për dhënie të kontratës.

Andaj, **kërkojmë OSHP të mos e tejkalojë këtë mospërputhje dhe të mos e trajtojë si mangësi të korrigjueshme, por ta konstatojë se kriteri 2.1 nuk është përmbushur dhe ta eliminojë OE-në e rekomanduar si të papërgjegjshëm.** Për më tepër, **kërkojmë verifikimin e dokumenteve të paraqitura me OIK-un dhe institucionin përkatës, pasi rekomandimi për kontratë i një OE-je që nuk dëshmon profilin e kërkuar do të përbënte një shkelje serioze të kërkesave të DT-së.**

Shiko dëshmin Diplomen dhe licence A me drejtim tjeter jo siq e ka kerkuar AK.



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

*Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
Inženjerska komora Republike Kosova
Chamber of Engineers of The Republic of Kosovo*

Në përputhje me nenin 26 të Ligjit Nr.08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, nenet 5,7,8,9 dhe 11 të Rregullores për Procedurën e Licencimit, Rilicencimit, Mirëmbajtjen, Pezullimin dhe Revokimin e Licencës së Inxhinierit të Licencuar të Odës me numër protokoli 8651/24 të datës 31.12.2024 dhe bazuar në Vendimin e Komisionit Vlerësues me numër 679/25 të datës 12.08.2025, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, lëshon:

LICENCA A

INXHINIER I LICENCUAR
ARLINDA CAKAJ

Titulli akademik: Doktor në Inxhinieri dhe Teknologji
Drejtimi: Inxhinieri dhe Teknologji

Data e lindjes: 15.08.1997

Numri i licencës: N-1155

Data e lëshimit:
12.08.2025

Data e skadimit:
12.08.2030

Kryetar i Odës
Arsim RAPUÇA

Prishtinë





REPUBLIKA E KOSOVËS
UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS NË PRISHTINË

REPUBLIC OF KOSOVO
UNIVERSITY OF PRISHTINA
"HASAN PRISHTINA"



FACULTY OF CIVIL ENGINEERING AND ARCHITECTURE IN PRISHTINA

Diplomë Diploma

ARLINDA SKENDER CAKAJ

U lind më 15.08.1997 në Prishtinë.

U regjistrua në vitin akademik 2015/2016.

Studimet i mbaroi më 25 korrik 2018 në:

DEPARTAMENTI I NDËRTIMTARISË

PROGRAMI INXHINTERI E AMBIENTIT

dhe mori titullin:

BACHELOR I NDËRTIMTARISË

Born on 15.08.1997 in Prishtina.

Was enrolled in the academic year 2015/2016.

Completed his/her studies on 25 July 2018 in:

DEPARTMENT OF CIVIL ENGINEERING

ENVIRONMENTAL ENGINEERING PROGRAM

and was awarded the title:

BACHELOR OF CIVIL ENGINEERING

Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 6

Gjithsej 180 pikë - ECTS

Nota mesatare gjatë studimeve 8.78

Prishtinë, 27 korrik 2018

Level of qualification according to the National Qualifications Framework: 6

Total ECTS 180

Average grade of studies: 8.78

Prishtina, 27 July 2018

Nr. 1832

Dekani / Dean



Prof. Dr. Abdullah Zejnullahu

Rektori / Rector

Prof. Dr. Marjan Dema



Si deshmi tjetër shikoni se qfar keni kerkuar ju si AK dhe si do duhej te ishte diploma dhe Licenca.

	REPUBLIKA E KOSOVËS UNIVERSITETI I PRISHTINËS	REPUBLIC OF KOSOVO UNIVERSITY OF PRISHTINA	 Nr. 1 Dt. Neshim
FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE DHE TEKNOLOGJISË NË MITROVICË		FACULTY OF GEOSCIENCES AND TECHNOLOGY IN MITROVICË	
Diplomë Diploma			
VEHBI MUHARREM GOXHULI			
U lind më 02.10.1966 në Makërmal.		Born on 02.10.1966 in Makërmal.	
U regjistrua në vitin akademik 2000/2001 në studimet master.		Was enrolled in the academic year 2000/2001 in master studies.	
Studimet i mbaroi më 31 mars 2007.		Completed his/her studies on 31 March 2007.	
E mbrojti me sukses temën e magjistraturës:		Defended his/her Magister thesis:	
Përcaktimi i ndikimit të deponive të hirit nga TC Kosova A në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore		Determining the impact of ash dumps from TC Kosova A on surface and underg water pollution	
INXHINIERI E MBROJTJES SË MJEDISIT		ENVIRONMENTAL PROTECTION ENGINEERING	
Titulli i fituar: MAGJISTËR I SHKENCAVE TEKNIKE		Obtained the title: MASTER OF TECHNICAL SCIENCES	
Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 7 Prishtinë, 9 tetor 2024		Level of qualification according to the National Qualifications Framework: 7 Prishtina, 9 October 2024	
Nr. 61			
Dekani / Dean Prof. Asoc. Dr. Fejtim Kutlliovi 		Rektori / Rector Prof. Dr. Arben Hajrullahu 	
			



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

*Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
Inženjerska komora Republike Kosova
Chamber of Engineers of The Republic of Kosovo*

Në përputhje me nenin 26 të Ligjit Nr.08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, nenet 5,7,8,9 dhe 11 të Rregullores për Procedurën e Licencimit, Rilicencimit, Mirëmbajtjen, Pezullimin dhe Revokimin e Licencës së Inxhinierit të Licencuar të Odës me numër protokoli 8651/24 të datës 31.12.2024 dhe bazuar në Vendimin e Komisionit Vlerësues me numër 619/2025 të datës 22.07.2025, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, lëshon:

LICENCA A

INXHINIER I LICENCUAR
VEHBI GOXHULI

Titulli akademik: Maxhistër I Shkencave Teknike
Drejtimi: Inxhinieri e Mbrojtjes së Mjedisit

Data e lindjes: 02.10.1966

Numri i licencës: M-0223

Data e lëshimit:
22.07.2025

Data e skadimit:
22.07.2030

Kryetar i Odës
Arsim RAPUCA

Prishtinë



Pretendimi ankimre 5.

AK: ka kerkuar: Dëshmitë për kërkesën numër 3. Një listë të mjeteve apo paisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për te ekzekutuar kontraten në fjalë- paisjet dhe makineria në dispozicion duhet të deshmohen me kopje të librezave -valide mbi pronsin e tyre ose DUD-I doganore, ose fatura e blerjes ose kontrata mbi qiramarrjen të dorëzohen në kopje të qarte dhe të lexueshme.

OE I rekomanduar **Ermal Syla B.I.** të eliminohet nga procedura, pasi nuk e ka përmbushur kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues për **paraqitjen e listës së mjeteve dhe pajisjeve teknike në dispozicion për ekzekutimin e kontratës.**

Edhe pse OE ka paraqitur dokumente për disa makineri, dokumenti i dorëzuar **nuk është identifikuar si lista e mjeteve për këtë aktivitet të prokurimit:** nuk përmban titullin e kontratës, numrin e prokurimit apo ndonjë të dhënë tjetër që e lidh atë listë me kontratën konkrete. Për rrjedhojë, nga dokumentacioni i ofertës **nuk mund të konstatohet se për cilin projekt është hartuar dhe dorëzuar kjo listë,** dhe as që makineritë e deklaruar janë pikërisht ato që OE i ka vënë në dispozicion për realizimin e kësaj kontrate.

Kërkesa e AK-së ka qenë e qartë: të paraqitet **lista e mjeteve/pajisjeve që janë në dispozicion për ekzekutimin e kontratës,** e shoqëruar me dëshmitë përkatëse. Nuk mjafton vetëm paraqitja e dokumenteve të makinerive pa një listë të identifikueshme dhe të lidhur qartë me aktivitetin konkret të prokurimit.

Prandaj, dokumentacioni i dorëzuar nuk mund të konsiderohet si përmbushje e kërkesës së AK-së, pasi mungon elementi themelor që dëshmon **cilat mjete janë deklaruar për këtë kontratë.**

Në këto rrethana, OE **Ermal Syla B.I. duhet të eliminohet si tenderues i papërgjegjshëm për mospërmbushje të kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit,** pasi gjatë vlerësimit nuk mund të prezumohet se një listë e paidentifikuar i përket kontratës konkrete. Kërkesat e tenderit duhet të vlerësohen mbi dokumentacionin e dorëzuar dhe jo mbi supozime. Rregullat e prokurimit kërkojnë që tenderët të vlerësohen sipas kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Mbi bazën e fakteve dhe provave të sipër prezantuara, dhe pas administrimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik, konstatohet se elimini i OE dhe shpallja e ofertës si e pasuksesshme ka qenë si rrjedhojë e një vlerësimi të qellimshëm të komisionit vlerësues të ofertave dhe zyrtarit përgjegjës të prokurimit, prandaj me qëllim të evitimit të raportimit të provave dhe deshmive në instanca tjera propozojme që të nxjerrni këtë:

VENDIM

- I. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e dorëzuar nga Operatori Ekonomik "Company Murseli SH.P.K.
- II. **Anullohet**, njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i dates 12.08.2026, si i kunderligjeshem dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**,

Operatori Ekonomik ka ofruar dëshmitë konkrete ligjore dhe se cdo tentative për eliminim të ofertës sonë bie ndesh me parimin e barazisë, mosdiskriminimit dhe transparencës të sanksionuar me LPP. Prandaj, përmes kesaje kerkese kërkojmë aplikimin strikt të nenit 108/A të LPP-se, trajtimin dhe argumentimin e secilit pretendim ankimor në të kundërtën në kemi të administruara të gjitha provat të cilat do të deponojmë jo vetëm në OSHP por edhe në Prokurorinë Perkatëse.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*